

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTERI

Nr. 1652/Prol.

15

Thirrje me 27/06/2022

URDHËR

Nr. 292, Datë 27 / 06 / 2022

**"PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT,
NOTERES GLADIOLA MILOTI"**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja "e)", dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë", të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Me Urdhër nr. 495, datë 31.08.2021 të Ministrit të Drejtësisë është vendosur fillimi hetimi administrativ për mosushtirimin e veprimtarisë së noterit Gladiola Miloti, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Shkodër, pasi gjatë ushtrimit të detyrave për verifikimin e respektimit të kuadrit ligjor në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, nga ana jonë është evidentuar se, noteria Gladiola Miloti ka pezulluar veprimtarinë më datë 01.09.2020, sipas të dhënave referuar Qendres Kombëtare të Biznesit.

Për kryerjen e këtij hetimi administrativ me Urdhër nr. 107, datë 24.03.2022 të Ministrit të Drejtësisë është vendosur zgjatja e afatit të hetimit të nisur me Urdhër nr. 495, datë 31.08.2021 të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në nenin 28, pika 2 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", të ndryshuar, pasi është vlerësuar se, gjendemi përpara një rasti kompleks për të cilin do të nevojitej më shumë kohë për realizimin e një hetimi të plotë, në mënyrë që të vlerësohet saktë nëse ndodhemi përpara një situatë faktike ku nga noteria është pezulluar veprimtaria noteriale pa as një shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Nga verifikimet e kryera nga grupi kontrollit, rezultoi se zyra noteriale e deklaruar nga noteria Gladiola Miloti, në adresën "Lagja "Beshikë", Bulevardi "Gjergj Kastrioti" Adresë Private 3-karëshe, kati për dhe, Lezhe", për ushtrimin e veprimtarisë së saj noteriale, nuk u gjend, në këtë adresë të deklaruar nga noteria për ushtrimin e veprimtarisë noteriale (ashtu siç ushtron veprimtarinë tregtare, një tjetër subjekt, "Barber Shop", dokumentuar me foto nga grupi i kontrollit, realizuar më datë 08.09.2021 dhe 19.05.2022, ku janë mbajtur njëkohësisht procesverbalet përkatëse.

Gjithashtu, sipas të dhënave në ekstraktin historik të OKH, rezultoi se noteria ka pezulluar aktivitetin e saj duke filluar nga data 01.09.2020, si dhe nga verifikimi i realizuar në Regjistrin Noterial Shqiptar rezultoi që noteria nuk ka regjistruar më akte noteriale që prej datës 18.12.2019.

Me email-in datë 08.09.2021 noteria Gladiola Miloti, pasi është njoftuar nga Ministria e Drejtësisë mbi fillimin e hetimit për mosushtimin e veprimtarisë noteriale nga ana e saj, na ka informuar se ka njoftuar Dhomën Kombëtare të Noterisë me datë 08.09.2020 dhe Ministrinë e Drejtësisë me e-mailin datë 22.09.2020 (kur është kërkuar të paraqitet personalisht pranë institucionit tonë për të tërhequr raportin paraprak mbi vlerësimin e dokumentacionit të përcjellë nga ana e saj, duke qenë se ishte kthyer nga shërbimi postar) lidhur me arsyen e kalimit të aktivitetit të zyrës në gjendje "Pasive", në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për shkak se ka qenë me raport leje barrëlidhje.

Gjithashtu, përmes këtij e-maili noteria ka përcjellë kopje të skanuar të raporteve mjekësore që tregojnë se, për periudhën 28.10.2020- 23.06.2021 ka qenë me leje barrëlidhje.

Referuar pretendimeve të noteres, përcjellë me e-mailin datë 08.09.2021 me qëllim realizimin e një hetimi sa më të plotë e të drejtë me shikresën nr.4287/S-prot., datë 17.09.2021 i është kërkuar informacion Dhomës Kombëtare të Noterisë nëse noteria znj. Gladiola Miloti ka paraqitur ndonjë kërkesë/arsye të tjera të përligjura për mos ushtimin e veprimtarisë së saj noteriale, pranë Dhomës ashtu sikundër ajo pretendon, dhe nëse po, i është kërkuar të na informoj se, cili ka qenë qëndrimi zyrtar i mbajtur nga Dhoma lidhur me këtë rast.

Nga ana e Dhomës Kombëtare të Noterisë nuk është përcjellë informacioni i kërkuar çka na ka detyruar të rikërkojmë sërish këtë informacion me shikresën nr.1333-prot., datë 03.03.2022 dhe njëkohësisht është vendosur zgjidhja e afatit për kryerjen e këtij hetimi përpara se të arrihet në një vendimarrje nga Ministri i Drejtësisë për shkak të kompleksitetit të kësaj çështje.

Pavarësisht se nga ana jonë i është rikërkuar sërish informacion Dhomës, nga ana e tyre nuk kemi ende një përgjigje lidhur me faktin nëse noteria Gladiola Miloti ka paraqitur ndonjë kërkesë/arsye të tjera të përligjura për mos ushtimin e veprimtarisë së saj noteriale, pranë Dhomës ashtu sikundër ajo pretendon.

Në nenin 18. të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", përcaktohen ndër të tjera, rastei kur noteri mund të kërkojë pezullimin, afatet e pezullimit, si dhe autoritetin që ka kompetencën për pranimin e kërkesës për pezullim. Referuar kësaj dispozite parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për pezullim, Ministrisë të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, dhe është Ministri i Drejtësisë ai që vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës.

Nga verifikimi i kryer rezultoi që noteria Gladiola Miloti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për pezullimin e ushtimit të veprimtarisë noteriale, detyruar Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi.

Sa i përket pretendimit të noteres se, kalimi i aktivitetit të zyrës në gjendje "Pasive" në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është bërë për shkak se ka qenë me raport leje barrëlidhje dhe për këtë arsye ka njoftuar Dhomën Kombëtare të Noterisë, sqarime se:

Së pari, në ligjin e noterisë janë përcaktuar qartë rastet kur nga noteri mund të kërkohej pezullimi i aktivitetit të tij dhe autoriteti ku paraqitet kërkesa për pezullim. Edhe sikur noteria Gladiola Miloti të kishte paraqitur kërkesë për pezullim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, sikundër ajo pretendon që e cila nuk është konfirmuar nga DIJKN, pasi nuk kemi një përgjigje nga ana e saj, sërish do të ishte në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi pasi kërkesa do të duhej të paraqitej edhe pranë Ministrisë të Drejtësisë, i cili vendos përfundimisht për pranimin ose jo të kësaj kërkesë.

Së dyti, referuar raporteve mjekësore, të përcjellë nga noteria Gladiola Miloti me email që tregojnë se, për periudhën 28.10.2020- 23.06.2021 ka qenë me leje barrëindje, rezultoi se edhe pse leja për barrëindje përfundon më datë 23.06.2021, noteria nuk është rikthyer në zyrë për ushtrimin e veprimtarisë së saj noteriale, si dhe statusi i saj në OKB ka vazhduar po pasiv, referuar verifikimeve të kryer në OKB dhe kontrollit të ushtruar nga grupi kontrollit më datë 08.09.2021 në vendin në të cilin është deklaruar ushtrimi veprimtarisë noteriale prej saj.

Për më tepër edhe pas kontrollit të kryer sërish më datë 19.05.2022 në qytetin e Lezhës, pas zgjatjes së afatit të hetimit të vendosur me urdhrin nr. 107, datë 24.03.2022 të Ministrisë të Drejtësisë, nga grupi kontrollit është konstatuar se, në adresën e deklaruar për ushtrimin e veprimtarisë noteriale nga noteria Gladiola Miloti vazhdon të ushtroj veprimtarinë tregtare po i njëjti subjekt tregtar relatuar këtu në procesverblin e mbajtur më datë 19.05.2022 nga grupi kontrollit si dhe dokumentuar me foto të realizuara po në këtë ditë.

Pra siç shihet edhe nëse do të konsideronim se, mungesa e noterës është për shkak të përligjura pra, pasi ajo ka qenë me leje barrëindje, ky argument nuk vlen më në momentin që rezultoi se noteria Gladiola Miloti nuk ka rifilluar ushtrimin e veprimtarisë noteriale, pasi leja për barrëindje ka përfunduar që më datë 23.06.2021.

Bazuar në sa më sipër, duke iu referuar edhe veprimin të fundit të realizuar nga noteria Gladiola Miloti në RNSH, datë 18.12.2019, konstatohet se noteria ka mbi dy vite që nuk ofron shërbim ndaj publikut, pa miratimin e Ministrisë të Drejtësisë.

Si përfundim, referuar rrjedhës kronologjike të fakteve të sipërcituara, si dhe parashikimeve ligjore të nenit 63, pika 1, gërma "m" të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" të ndryshuar, ku përcaktohen "Detyrat e Noterit", dispozitë e aplikuar për rastin në fjalë në harmoni me parashikimet e nenit 18 të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" të ndryshuar, mbi kërkesën për "Pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit me kërkesën e tij", konkludojmë se, pavarësisht të gjitha instrumenteve ligjore që ka patur ky subjekt, me neglizhencë apo vetëveprim ka sjellë si pasojë, braktisjen e detyrës.

Rezulton se, noteria Gladiola Miloti është në kushtet e braktisjes së detyrës sipas parashikimeve të nenit 63, pika 1, gërma "m" ku citohej se: "Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme: siguron mbajtjen hapur të zyrës noteriale, sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim".

Gjithashtu në pikën 1, gërma "e" të nenit 21, të Ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", të ndryshuar parashikohet se: "1. Hapja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhrin të Ministrisë të Drejtësisë, kur noteri: a) nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohë

datë në 60 ditë fresht pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë
Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë
14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të përmës
8, të pikës 1, të nenit 21, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë", të ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Gladiola Miloti, anëtare e Degës Vendore
të Noterisë Shkodër, pasi nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohore mbi dy vite,
pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të
Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. Matilda Hoxha dhe znj. Diana Toro, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Një noter i caktuar nga Degja Vendore e Noterisë Shkodër;
 - c.) Një përfaqësues i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres
Gladiola Miloti, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij Urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare
e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria
e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e
Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e
Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të
Pastrimit të Parave, bankat e nivelet të dytë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë
përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet
e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të
dokumenteve arkivore, nëse ka të tilla.
6. Degja Vendore e Noterisë Shkodër dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga
marrja djehti e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në
përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë".
7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij
Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkives, noterit të përcaktuar nga degja
vendore përkatëse e noterisë, brenda 10 ditëve pune.

8. Ndaj këtij urdhri, noterit mund të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.

9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, pas kullimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Regullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dogmë Vendore e Noterisë Shkodër, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij Urdhri noterës Gladiola Miloti, Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Dogmë Vendore të Noterisë Shkodër.

Ky urdhër lryn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ilir Meta

Ilir Meta

